



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit
P- 56
Prishtinë, më 18 prill 2012

PROCESVERBAL

**IMBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 18 PRILL 2012**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 83 deputetë.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e

1. Debat parlamentar lidhur me gjendjen në veri të Kosovës

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të vetme të rendit të ditës, ftoi kryetarin e GP të PDK-së, për prezantimin dhe arsyetimin të kërkesës për debat.

Adem Grabovci, në fillim të arsyetimit të kërkesës për mbledhje të jashtëzakonshme tha se grupi prej 45 deputetëve, nënshkruar, ka kërkuar nga Kuvendi të mbajë një mbledhje të jashtëzakonshme me qëllim të shqyrtimit të situatës në veri të vendit.

Në vazhdim tha se situata në veri të vendit tash e 13 vjet ka qenë e rëndë, ndërsa, sulmi kriminal në familjen Haradinaj, është edhe një goditje ndaj shtetit të Kosovës, ndaj demokracisë dhe ndaj parimeve të lirisë dhe të drejtave të njeriut.

Më tej theksoi se situata në veri të vendit po e cenon rendin kushtetues dhe ligjor të Kosovës dhe kjo godet rëndë edhe autoritetin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Ai kërkoi që për këtë çështje të debatohet për hapat e mëtutjeshëm të institucioneve të Republikës së Kosovës

dhe mekanizmeve të sigurisë ndërkombëtare, në mënyrë që gjendja e sigurisë në këtë pjesë të vendit të futet nën kontroll, për të siguruar çdo qytetar, pa dallim etnie që jetojnë në këtë pjesë të Kosovës.

Në fund ai theksoi se pas debatit në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare, do të harmonizojnë tekstin me rekomandime, që në fund të mbledhjes së jashtëzakonshme do të adresohen për votim dhe miratim.

Ministri **Bajram Rexhepi**, në emër të Qeverisë së Kosovës paraqiti situatën e përgjithshme në këtë pjesë të vendit pas zhvillimeve të fundit.

Ai gjendjen e përgjithshme në Republikën e Kosovës e vlerësoi të qetë, me përjashtim të asaj në veri të vendit, të cilën e vlerësoi të tensionuar si rezultat i veprimtari të grupeve kriminale të shtetit serb. Gjendja në atë pjesë të Kosovës po mbahet nën kontroll nga Policia e Kosovës, EULEX-i, dhe KFOR-i.

Ai më tej theksoi se përgjegjësinë për një gjendje të tillë e mbajnë institucionet e Serbisë, të cilat po dëshmojnë edhe një herë agresion ndaj shtetit të Kosovës.

Ministri Bajram Rexhepi vlerësoi se moszbatimit të marrëveshjeve dhe sulmeve të fundit ndaj shtetit të Kosovës, i kanë kontribuar edhe vizitat e zyrtarëve të shtetit të Serbisë, të cilët po hyjnë nëpërmjet rrugëve alternative në territorin e Kosovës, ndërkohë që është obligim i KFOR-it mbyllja e këtyre rrugëve alternative.

Në vazhdim ai përshkroi sulmin në familjen e Selver Haradinajt, që ndodhi me 8 prill 2012, me ç'rast si pasojë e shpërthimit të eksplozivit të vendosur në banesën e tij, humbi jetën kryefamiljari Selver Haradinaj, ndërsa u plagosen tre fëmijët e tij. Hetimet e para flasin për një sasi prej 500 gr. eksploziv të vendosur në banesën e tij, theksoi Bajram Rexhepi.

Më tutje ai përshkroi edhe hetimet të cilat kanë filluar menjëherë pas rastit të ndodhur, për të cilat tha se janë në proces e sipër.

Pas kësaj ngjarje, ai tha se pranë lagjes së “Tre Rrokaqiejve”, Policia e Kosovës ka vendosur një pikë statike, të cilën grupi prej 200 kriminelëve serbë e kanë demoluar menjëherë pas vendosjes së saj. Patralla e Policisë së Kosovës është tërhequr nga ajo pikë statike, në mënyrë që të vendosen dy pika statike tjera, të cilat janë përforcuar me forca policore në atë pjesë. Ai në vazhdim konstatoi se kemi shtuar numrin e policëve në lagjet e banuara me popullatë etnike në atë pjesë.

Në fund ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, theksoi se jemi në favor të koordinimit me KFOR-in dhe EULEX-in, por nuk do të hezitojmë të veprojmë sipas Kushtetutës për vendosjen e rendit dhe sundimin e ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fillimisht i shprehu ngushëllime familjes së Selver Haradinajt, ndërsa gjendjen në atë pjesë të vendit e vlerësoi të përkeqësuar, duke marr parasysh se atje ka anarki, krim të organizuar, vrasje të qytetarëve të Republikës së Kosovës, shkatërrim të pikave policore etj.

Në vazhdim ai tha se Qeveria e Kosovës dhe faktorët ndërkombëtarë për siguri, kanë pjesë të përgjegjësisë për situatën e krijuar në atë pjesë të vendit.

Më tej deputeti Ismet Beqiri u fokusua në bisedimet të cilat po i zhvillon Qeveria e Republikës së Kosovës, me palën serbe në Bruksel, për të cilat tha se Grupi që ai përfaqëson i ka konsideruar politike, ndërsa në fund vlerësoi se në atë pjesë të vendit duhet të fillojnë të punojnë gjykatat, të sigurohet mbrojtja e jetës së qytetarëve, të lirohen të burgosurit e arrestuar nga xhandarmëria serbe, të arrestohen kriminelët dhe të dalin para drejtësisë.

Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se 11 ditë pas sulmit mbi familjen e Selver Haradinajt, Kuvendi po mban një mbledhje të jashtëzakonshme.

Ai në vazhdim, duke kritikuar Qeverinë e Kosovës për mosushtrim të kompetencave shtetërore, theksoi se në situata të jashtëzakonshme edhe veprimet duhet të jenë urgjente.

Më pas theksoi se përderisa kryeministri i vendit mban ligjëratë në një universitet në SHBA, në të njëjtën kohë në veri të vendit veprimi i strukturave kriminale serbe dhe vrasja e qytetarëve të Kosovës, po bëhen gjithnjë e më të zakonshme.

Më pas ai u fokusua në mënyrë kronologjike në situatën në veri të vendit që nga paslufta e deri më tani, për të cilën tha se në ditët e para të hyrjes së trupave të KFOR-it në Kosovë, në veri të vendit nuk ka pasur struktura paralele, dhe se që nga ajo kohë e deri më tani, ka ndodhur një tërheqje e pakuptimtë nga veriu i vendit i institucioneve të Kosovës dhe pas shpalljes së pavarësisë i institucioneve të Republikës së Kosovës.

Në fund deputeti Visar Ymeri theksoi se grupi që ai përfaqëson ka ofruar alternativën e cila është në favor të forcimit të sovranitetit shtetëror në atë pjesë të vendit, duke potencuar, mes tjerash, forcimin e FSK-së, ndërprerjen e bisedimeve me Serbinë, shkatërrimin e strukturave ilegale serbe në Kosovë, etj.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se Grupi që ai përfaqëson vlerëson se problemet në veri të vendit janë më të theksuara se në çdo pjesë tjetër, ndërsa Qeveria e Kosovës e ka zhveshur vetveten për t'u marrë me zgjidhjen e këtyre problemeve.

Në vazhdim ai kërkoi që Qeveria të tregojë para qytetarëve të Kosovës dhe Kuvendit se cilat masa i ka ndërmarr ajo për normalizimin e situatës në veri të vendit, ndërsa infiltrimin e organeve serbe në Kosovë e vlerësoi si paaftësi të institucioneve të Kosovës, për ushtrimin e sovranitetit të saj në tërë territorin e vendit.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se nga mbledhja e kaluar ishte një kërkesë që me rastin e debatit për gjendjen në veri të vendit, në Kuvend të jenë prezentë kryeministri dhe Kabineti qeveritar.

Në vazhdim tha se Kosova është çështje e përbashkët e të gjitha subjekteve politike pozitë-opozitë dhe se për këtë çështje duhet të kemi një gjuhe të përbashkët. Ajo më tej kërkoi që pakoja e Ahtisarit të zbatohet edhe në veri të vendit, ndërsa lidhur me vrasjen e Selter Haradinajt, theksoi se rasti duhet të zbardhet sa më parë, së bashku me NATO-n, KFOR-in dhe EULEX-in.

Petar Miletqi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, theksoi se nuk është hera e parë që në Kuvendin e Kosovës diskutohet për gjendjen në veri të Kosovës.

Në vazhdim tha se problemet në veri nuk do t'i zgjidhë vetëm policia, por ato zgjidhen me dialog politik. Përgjegjësia jonë në Kuvend si dhe e Qeverisë së Kosovës, është shumë e madhe, ndërsa ndihma e bashkësisë ndërkombëtare është jo vetëm e mirëseardhur, por edhe domosdoshmëri, theksoi deputeti Petar Miletqi.

Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar "6+", tha se Grupi që ai e përfaqëson, zhvillimet në veri të vendit i konsideron shqetësuese, të cilat, si të tilla përfshijnë periudhën që nga paslufta.

Në vazhdim ai theksoi se Policia e Kosovës, EULEX-i dhe KFOR-i duhet t'i kryejnë detyrat e veta sipas mandatit që kanë.

Grupit Parlamentar "6+" vlerëson se zgjidhja e vetme për veriun është pakoja e Ahtisarit, pa plus dhe pa minus, tha deputeti Kinolli.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët:: Ardian Gjini, zv.kryeministri Hajredin Kuçi, ministri Enver Hoxhaj, ministri Idriz Vehapi, Sabri Hamiti, Alma Lama, Blerim Shala, Gëzim Kelmendi, Goran Marinković, ministri Agim Ceku, ministri Memli Krasniqi, Xhevahire Izmaqi, Vjosa Osmani, Albin Kurti, Ahmet Isufi, Jeton Svirca, Vesna Mikiqi,

ministri Bedri Hamza, Sadri Ferati, Glauk Konjufca, Rada Trajković, Emilija Rexhepi, ministri Nenad Rashiq, ministri Fehmi Mujota, kryeministri Hashim Thaçi, Agim Kuleta dhe Hydajet Hyseni, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputetët: Ramiz Lladrovci, Valbona Dibra dhe Afrim Hoti, thanë se diskutimet e tyre do t'i dorëzojnë me shkrim.

Në ndërkohë grupet parlamentare opozitare lëshuan sallën e mbledhjes.

Në vazhdim, kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 45 deputetë dhe ftoi kryetarin e GP të PDK-së, që në emër të propozuesit, ta marrë fjalën.

Adem Grabovci falënderoi deputetët për kontributin lidhur këtë pikë të rendit të ditës, ndërsa theksoi se për thirrjen e kësaj mbledhje të jashtëzakonshme i kemi respektuar rregullat procedurale.

Përmes këtij debati kemi dashur që në fund t'i nxjerrim rekomandimet e duhura në bashkëpunim me të gjitha grupet parlamentare. Mungesën e deputetëve të opozitës në sallën e mbledhjes, ai e quajti joserioze.

Kryetari, pas kësaj, e përfundoi debatin lidhur me gjendjen në veri të Kosovës.

Kryetari konstatoi të mbyllur punimet e mbledhjes së sotme, në ora 18:40.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale